

Vendim nr. 36, datë 28.01.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Asim Vokshi, Anëtar

Genti Ibrahimimi, Anëtar

në datën 28.01.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 12 (V) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: VASIL ÇAROSHI

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 13-2024-1640 (419/417), datë 11.04.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan; nr. 1975 (30-2024-6586), datë 19.09.2024 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm; nr. 00-2025-706, datë 24.04.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 31, 42, 43 dhe 142, paragrafi 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 28 dhe vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është dënuar me 6 vjet burgim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me vendimin nr. 648 (13-2018-5450), datë 08.10.2018, për kryerjen e veprës penale “Mashtrimi”, të kryer më shumë se një herë, me pasoja të rënda. Ajo gjykatë ka urdhëruar që vuajtja e dënimit të fillojë nga dita e ekzekutimit të tij. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. 10-2019-480/93, datë 20.03.2019. Në datën 11.12.2019 kërkuesi është arrestuar në Greqi, me qëllim ekstradimin e tij në Shqipëri dhe është dorëzuar tek autoritetet shqiptare më 28.09.2020. Në datën 29.09.2020 ai ka filluar vuajtjen e dënimit.

2. Ndërkohë, në datën 25.10.2018, me vendimin nr. 2802, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka deklaruar fajtor kërkuesin për kryerjen e veprës penale “Mashtrimi”, të kryer më shumë se një herë, me pasoja të rënda, duke e dënuar përfundimisht me një dënim të vetëm prej 6 vjetësh burgim. Mbi ankimin e kërkuesit, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 301, datë 05.04.2022, ka vendosur mospranimin dhe ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit më 16.01.2023, që i është njoftuar atij në datën 10.02.2023.

3. Në datën 13.01.2023 kërkuesi ka paraqitur në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan kërkesën me objekt njohjen e dënimit të kryer në shtetin grek për periudhën 11.12.2019-28.09.2020, gjithsej 292 ditë paraburgim, duke e llogaritur në masën e dënimit të dhënë me vendimin nr. 648, (13-2018-5450), datë 08.10.2018 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe të vendimit nr. 2802, datë 25.10.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe bashkimin e dënimeve të dhëna nga këto dy gjykata.

4. Ajo gjykatë, me vendimin nr. 13-2024-1640 (419/147), datë 11.04.2024, ka vendosur ndër të tjera, pranimin e kërkesës, duke i njohur dhe llogaritur në kohën e vuajtjes së dënimit ditët e qëndrimit në paraburgim në shtetin grek vetëm për vendimin nr. 648 (13-2018-5450), datë 08.10.2018 si dhe bashkimin e dënimeve të mbetura të pavuajtura në një dënim të vetëm, duke e dënuar me 6 vjet e 6 muaj burgim.

5. Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin nr. 1975 (30-2024-6586), datë 19.09.2024, ka vendosur lënien në fuqi të atij vendimi, duke arsyetuar, ndër të tjera, se është disponuar me të drejtë për bashkimin në një dënim të vetëm, dënimit të mbetur të pavuajtur, si dhe duke zbritur nga pjesa e pavuajtur e dënimit me burgim kohën e vuajtur në paraburgim në Greqi për efekt ekstradimi në shtetin shqiptar. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi.

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-706 datë 24.04.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit, duke arsyetuar se nga shqyrtimi i akteve dhe vendimmarrjes së gjykatave nuk konstatohet janë ngritur shkaqet e parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*).

7. Në datën 06.10.2025 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar në përputhje me parashikimet e Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 22.10.2025.

II

Pretendimet e kërkuesit

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, në mbështetje të kërkesës së tij, ka parashtruar se vendimet e kundërshtuara i kanë cenuar:

8.1. *Të drejtën për të mos u dënuar pa ligj*, të garantuar në nenin 29, pika 2, të Kushtetutës, pasi gjykatat kanë llogaritur gabim dënimet dhe bashkimin e tyre, duke i dhënë atij një dënim të ri më të rëndë dhe joproporcional, me 13 vjet burgim që tejkalon kufirin maksimal të lejuar nga KP-ja për veprën penale të mashtrimit, të parashikuar në nenin 143 të saj.

8.2. *Të drejtën për të mos u dënuar më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale*, të parashikuar në nenin 34 të Kushtetutës, pasi të dyja vendimet janë marrë në të njëjtën periudhë për të njëjtën vepër penale të parashikuar në nenin 143 të KP-së dhe kërkuesi është dënuar me të njëjtin dënim, me nga 6 vjet burgim. Këto vendime janë mbështetur në prova që, sipas kërkuesit, janë rrëzuar tërësisht nga vendime civile të formës së prerë, të cilat janë paraqitur prej tij në të gjitha shkallët e gjykimit.

8.3. *Të drejtën për një proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, në drejtim të:

8.3.1. *Parimit të paanshmërisë në gjykim*, pasi vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë është marrë në dhomën e këshillimit me të njëjtin gjyqtar si kryesues që ka marrë pjesë në dhënien e vendimeve nr. 00-2023-1077, datë 30.06.2023 dhe nr. 00-2025-388, datë 06.03.2025 të asaj gjykate, të cilat kanë lidhje me çështjen e themelit, duke mos garantuar drejtësi, paanësi dhe transparencë.

8.3.2. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar dhe pasqyruar me saktësi dhe vërtetësi faktet dhe rrethanat e çështjes pa u bazuar në argumentet e dhëna nga kërkuesi në rekurs, duke mos bërë një analizë e një vlerësim të drejtë provave dhe duke mos kryer një hetim të plotë gjyqësor.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

10. Kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, ndaj mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimin kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitimit, në varësi të elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë për kërkuesin. Në këtë drejtim, mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, pa ndjekur një radhë të caktuar të analizës së kriterëve, me pasojë moskalimin e saj në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kriterëve të tjera. Në rastin kur verifikohet dhe arsyetohet mosplotësimi i vetëm një kriteri, kjo vjen si rezultat i zbatimit të karakterit kumulativ të tyre dhe nuk nënkupton se kriteret e tjera paraprake humbasin rëndësinë që kanë për rezultatin e çështjes, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit kriter që të vendoset moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

11. Në çështjen konkrete, Kolegji çmon të ndalet në analizën e legjitimitimit *ratione materiae*. Në lidhje me këtë kriter, Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar se i është cenuar e drejta për të mos u dënuar pa ligj, e drejta për të mos u dënuar më shumë se një herë për të njëjtën

vepër penale dhe e drejta për një proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, të garantuara respektivisht nga nenet 29, 34, 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës.

12. Kolegji vëren se, pavarësisht se pretendimet janë parashtruar nga kërkuesi në drejtim të të drejtave të përmendura më sipër, në thelb, ai ka ngritur pretendime për llogaritjen e dënimeve dhe bashkimin e tyre, analizën e vlerësimin e provave dhe argumenteve të parashtruara në rekurs dhe moskryerjes së një hetim të plotë gjyqësor.

13. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues, nëse nuk shoqërohen me cenimin e të drejtave kushtetuese. Mënyra sesi gjykatat e zakonshme kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim përpara tyre nuk përbën lëndë kushtetuese (*shih vendimet nr. 5, datë 29.01.2025; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Detyra e kësaj Gjykate është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrarisht, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Ajo nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 29, datë 01.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se gjykata e shkallës së parë ka vendosur pranimin e kërkesës së kërkuesit, duke vlerësuar, ndër të tjera, se atij duhet t'i zbritet nga pjesa e pavuajtur e dënimit me burgim koha e vuajtur në paraburgim në shtetin grek për efekt ekstradimi në shtetin shqiptar në kuadër të ekzekutimit të vendimit penal të formës së prerë nr. 648 (13-2018-5450), datë 08.10.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, si dhe duhet kryer bashkimi i dënimit të mbetur të pavuajtur.

15. Ky vendim është lënë në fuqi nga gjykata e apelit, e cila e ka quajtur të drejtë arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë për bashkimin, si dhe ka analizuar mjaftueshëm shkaqet ankimore, duke arsyetuar se paraburgimi në Greqi duhet të llogaritet vetëm për efekt të vuajtjes së dënimit penal të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, pasi arrestimi në atë shtet është kryer pikërisht për ekzekutimin e atij vendimi. Ndërsa për pretendimin për llogaritjen e periudhës 01.10.2020- 05.04.2022, si periudhë burgimi, si për dënimin e dhënë nga gjykata e shkallës së parë

Elbasan, ashtu edhe për dënimin e dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ajo gjykatë është shprehur se ky pretendim bie ndesh me nenin 250 të KPP-së “Llogaritja e afateve të kohëzgjatjes së masave”, pasi kërkuesi nuk mund të jetë njëherësh edhe i dënuar për njërin vendim, edhe i paraburgosur për vendimin tjetër.

16. Gjithashtu, ajo gjykatë ka vlerësuar edhe pretendimin e ankuesit për dhënien e një dënimi të vetëm sipas sistemit të përthithjes, duke e vlerësuar si të pabazuar, pasi kjo mundësi parashikohet vetëm kur kryerja e disa veprave penale nuk tregon rrezikshmëri të madhe të të dënuarit, kusht që nuk plotësohet në rastin në shqyrtim dhe se kërkuesi është recidivist i posaçëm me rrezikshmëri shoqërore.

17. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, pasi ka vlerësuar se shkaqet e ngritura në të, nuk janë sipas atyre për të cilat neni 432 i KPP-së lejon rekursin kundër vendimeve të apelit. Ajo gjykatë ka theksuar se vendimi i bashkimit nuk është një vendim dënimi, pasi nuk përbën as disponim për llojin dhe masën e secilit dënim (objekt bashkimi), por përfaqëson vetëm rezultatin e aplikimit të një teknike zbatimi të dënimit në rastet kur ka më shumë se një të tillë. Gjithashtu, pretendimet e parashtruara në rekurs kundrejt vendimeve që kanë zgjidhur në themel çështjet penale nuk janë objekt shqyrtimi nëpërmjet kërkesës së paraqitur nga kërkuesi dhe, si të tilla, nuk përbëjnë shkak cenes ndaj vendimmarrjes objekt rekursi. Kolegji i asaj gjykate ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera të kërkuesit, duke e vlerësuar të drejtë argumentimin e tyre nga gjykatat më të ulëta.

18. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se bazuar në standardet kushtetuese të lartpërmendura, pretendimet e ngritura nga kërkuesi në drejtim të së drejtës për të mos u dënuar pa ligj, së drejtës për të mos u dënuar më shumë se një herë për të njëjtën veprë penale dhe së drejtës për një proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, janë haptazi të pabazuara.

19. Kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në drejtim të cenimit të parimit të paanshmërisë në gjykim, pasi vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë me nr. 00-2025-706, datë 24.04.2025, është marrë në dhomën e këshillimit me kryesues të njëjtin gjyqtar që ka marrë pjesë në dhënien e vendimeve nr. 00-2023-1077, datë 30.06.2023 dhe nr. 00-2025-388, datë 06.03.2025 të asaj gjykate, të cilat kanë lidhje me çështjen e themelit.

20. Në nenin 42 të Kushtetutës parashikohet, ndër të tjera, se të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për

mbrojtjen e tyre, ka të drejtën e një gjykimi nga një gjykatë e paanshme. E drejta për një gjykatë të paanshme nënkupton mungesën e paragjyqimeve nga gjyqtarët për çështjen e shtruar përpara tyre dhe që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e njëres prej palëve. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme të caktuar me ligj, kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo gjithashtu duhet të shikohet që bëhet (*shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023; nr. 38, datë 15.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Respektimi i parimit të paanshmërisë duhet të verifikohet duke aplikuar testin subjektiv, që ka të bëjë me verifikimin e bindjes ose të interesit personal të një gjyqtari në një çështje të caktuar, si dhe testin objektiv, me të cilin shqyrtohet nëse gjyqtari ka ofruar garanci procedurale të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim të anshmërisë (*shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023; nr. 23, datë 04.11.2008; nr. 11, datë 02.04.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Veçanërisht për sa i përket kriterit të dytë, nëse ky kriter zbatohet për anëtarët e trupit gjykues, ai nënkupton se përveç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues duhet të provohet nëse ka fakte bindëse të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër, edhe dukja e jashtme mund të ketë njëfarë rëndësie. Në përcaktimin nëse një çështje konkrete ka arsye logjike për të dyshuar se një gjyqtar nuk është i paanshëm, këndvështrimi i atyre që ankohen për diçka të tillë është i rëndësishëm, por jo vendimtar. Në fakt, vendimtare është nëse objektiviteti i këtyre dyshimeve është mjaftueshmërisht i bazuar (*shih vendimin nr. 49, datë 16.10.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Gjykata ka vënë në dukje se Gjykata e Lartë, sipas nenit 141 të Kushtetutës, ushtron rolin e saj si gjykatë ligji për të gjithë territorin e vendit dhe për shkak të kësaj karakteristike kushtetuese, në parim, nuk përjashtohet mundësia që i njëjti gjyqtar të japë disa vendime brenda të njëjtit proces gjyqësor, nëse çështjet ligjore që shqyrtohen janë të ndryshme. Gjykata, kur ka shqyrtuar pretendime për cenimin e parimit të paanshmërisë për shkak të pjesëmarrjes të të njëjtit gjyqtar në dhënien e dy vendimeve në Gjykatën e Lartë, ka analizuar nëse vendimet e kundërshtuara janë marrë në përfundim të proceseve gjyqësore që kanë karakteristika të dallueshme dhe që bazohen në konsiderata dhe vlerësime të ndryshme të gjyqtarëve. Sipas Gjykatës, pjesëmarrja e të njëjtëve gjyqtarë në dy vendimet e dhëna për rrethana të ndryshme të çështjes, nuk krijon dyshim të justifikuar për mosrespektimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme (*shih vendimin nr. 22, datë 20.05.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në rastin konkret, bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese dhe mbështetur në materialet e çështjes, Kolegji çmon të vlerësojë nëse përbërja e trupit gjykues të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ka cenuar ose jo parimin e paanshmërisë në gjykim nga pikëpamja e testit objektiv.

24. Në bazë të kësaj analize, Kolegji konstaton se njëri nga anëtarët e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ka dhënë vendimin nr. 00-2023-1077, datë 30.06.2023 (*procesi i parë*), që ka lidhje me çështjen e themelit për fajësinë e kërkuesit dhe vendimin nr. 00-2025-388, datë 06.03.2025 (*procesi i dytë*), që ka të bëjë me rivendosjen në afat për të paraqitur ankim është pjesë edhe e Kolegjit që ka dhënë vendimin e kundërshtuar nr. 00-2025-706, datë 24.04.2025 (*procesi i tretë*).

25. Pavarësisht për sa më sipër, Kolegji vëren se gjatë procesit të parë dhe të dytë gjyqësor Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk ka analizuar themelin e çështjes, por ka verifikuar plotësimin e kriterëve të pranueshmërisë së rekursit, të parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Kjo do të thotë se Gjykata e Lartë në atë rast ka mbyllur shqyrtimin e çështjes në fazën seleksionuese të shqyrtimit të rekursit, ku vetëm ka analizuar faktin nëse çështja duhej të shqyrtohej ose jo mbi bazën e rekursit të paraqitur, duke arritur në përfundimin se nuk duhej të shqyrtohej. Ndërkohë procesi i tretë ka të bëjë me bashkimin e dënimeve dhe njohjen e kohës së paraburgimit. Në lidhje me këtë vendim, Kolegji çmon se vendimi i bashkimit nuk është një vendim dënimi, pasi nuk përbën disponim për llojin dhe masën e secilit dënim objekt bashkimi. Për më tepër, Kolegji konstaton se edhe në këtë rast Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se shkaqet e ngritura në të, nuk janë sipas atyre për të cilat ligji procedural penal, neni 432 i KPP-së, lejon bërjen e rekursit, duke e mbyllur shqyrtimin e kësaj çështjeje në fazën seleksionuese.

26. Nisur nga sa më sipër, Kolegji vlerëson se pjesëmarrja e të njëjtit gjyqtar në dhënien e tre vendimeve në Gjykatën e Lartë *per se* nuk është element i mjaftueshëm për të arritur në përfundimin se është cenuar parimi i paanshmërisë në gjykim, pasi vendimet e kundërshtuara janë marrë në përfundim të proceseve gjyqësore që kanë karakteristika të dallueshme nga pikëpamja e çështjeve faktike dhe ligjore dhe që bazohen në konsiderata e vlerësime të ndryshme të gjyqtarëve. Në këto kushte, vetëm fakti se gjyqtari ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit në dy proceset e mëparshme gjyqësore nuk krijon dyshim të justifikuar për paragjykimin e çështjes nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë. Për rrjedhojë, vlerësohet se pretendimi për cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim është haptazi i pabazuar.

27. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.